



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETEROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21 Janar 2022

Nr: 2

VENDIM

**PËR CAKTIMIN E NUMRIT TË MONITORUESVE PËR ZGJEDHJET E PJESSHME PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 6.3.2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022 “Për caktimin e datës së Zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, nenit 19, pikat 1, shkronjat “ë” dhe “n” e 2, nenit 92/4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar

VENDOS:

- Të caktoj një numër prej 20 (njëzetë) monitoruesish për monitorimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme për Organet e Qeverisjes Vendore për Bashkitë, si më poshtë vijon:
 - Për bashkinë Durrës, të caktohet një numër prej 7 (shtatë) monitoruesish;
 - Për bashkinë Shkodër, të caktohet një numër prej 5 (pesë) monitoruesish;
 - Për bashkinë Dibër, të caktohet një numër prej 2 (dy) monitoruesish;
 - Për bashkinë Lushnjë, të caktohet një numër prej 4 (katër) monitoruesish;
 - Për bashkinë Rrogozhinë, të caktohet 1 (një) monitorues;
 - Për bashkinë Vorë, të caktohet 1 (një) monitorues.
- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 21 Janar 2022

Nr. 2

Për caktimin e numrit të monitoruesve për zgjedhjet e pjesshme për organet e qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022